# Sali Hasa

PROKUROR NË PROKURORINË E SARANDËS

Deklaratat e analizuara:

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2004 deri Periodik/Vjetor 2018)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2018




Pasuria bruto është rritur 1.5 herë.

\+ 160,391 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete në Bankë




Likuiditete në Cash




Pasuritë e Luajtshme




Pasuritë e Paluajtshme




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2005-2018 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga nga funksioni | 15,897,198 | 48.5% |
| Të ardhura nga paga e familjarëve | 15,073,349 | 46.0% |
| Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme | 1,165,698 | 3.6% |
| Të ardhura të tjera | 656,268 | 2.0% |
| Total | 32,792,513 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**Pa Probleme**

Subjekti Sali Hasa deklaron në vitin 2004 pasuri të paluajtshme në vlerë 2,500,000 lekë, truall plus objekt banimi i papërfunduar, të cilat i shet dhe të ardhurat e përfituara i kalon depozitë bankare. Në deklarimin e vitit 2006, subjekti shprehet të ketë përdorur gjendjen e kësaj depozite prej 2,500,000 lekësh për të paguar këstin e fundit me përfundim e ndërtimit të shtëpie banimi me sipërfaqe 153 m2 në Durrës me vlerë totale 50,000 USD, me kontratë sipërmarrje që nga vitit 1999.

Në vitin 2008, subjekti deklaron huamarrje nga persona të tretë në vlerë 1,000,000 lekë, e cila shërben si burim për blerjen e një automjeti me të njëjtën vlerë. Kjo hua do të shlyhet gjatë viteve në vazhdim pa interes.

Në vitin 2011, bashkëshortja e subjektit deklaron të ketë marrë kredi në vlerë 3,168,000 lekë me qëllim mbulimin e pagesës për kontratën e porosisë për një apartament në qytetin e Sarandës, aset i cili nuk është deklaruar më vete dhe nuk ka detaje më shumë për vlerën e tij.

Në vitin 2014, subjekti deklaron se dy fëmijët e tij kanë përfituar si dhuratë një sipërfaqe prej 1000 m2 tokë në Porto Palermo, Himarë, të regjistruar në ZVRPP Vlorë (për të cilën nuk jep vlerë aseti).